



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:058321

Datë: 29.07.2021

Numri i dokumentit: 02044613

PS.nr. 22/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË P., DEPARTAMENTI SPECIAL, kryetarja e trupit gjykues Suzana Çerkini me bashkëpunëtoren profesionale Lindita Sylejmani, në çështjen penale kundër të pandehurve E.J nga Komuna V, për shkak të veprës penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK, T.B nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.10/2019 të datës 08.01.2021, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 24.05.2021 dhe datë 27.05.2021, me praninë e prokurorit special Naim Abazi, të pandehurit E.J me mbrojtësin avokat Hekuran Haxhimusa sipas autorizimit dhe të pandehurit T.B., , me datë 27.05.2021 mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

- 1. E.J.,** i biri i R., dhe nënës N e gjinisë A, i lindur me datë ///, i lindur në P., , me vendbanim në fshatin R-Komuna e V së, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin ekonomik, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim të RKS ///,
- 2. T.B.,** , i biri i A dhe nënës H, e gjinisë J, i lindur me datë /// në F.K , ku edhe tani jeton në rr. “///”, nr.//, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin e hotelarisë, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim të RKS ///,

JANË FAJTORË

Sepse,

1. I pandehuri E.J.,,

Gjatë periudhës kohore 09.08.2016 deri më datën 22.03.2019, përmes biznesit “C////” Sh.p.k., me seli në rrugën “Avdi Kelmendi” në Lipjan, me qëllim të fshehjes apo shmangies pjesërisht apo tërësisht të pagesës së tatimit që parashihet sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji nr.03/L-222), të sanksionuar sipas nenit 63 par.1, duke dhënë shënime të pavërteta lidhur me të ardhurat e bizneseve të tij “Cometa” Sh.p.k., me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore, ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës me shumën e përgjithshme 8,268.60 euro, në emër të biznesit të lartcekur,

- me këtë ka kryer veprë penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.1 të KPRK,

2. I pandehuri T.B., ,

Gjatë periudhës 01.01.2014 deri më datë 21.03.2019, përmes biznesit “////” Sh.p.k., në territorin e Kosovës, me qëllim të fshehjes apo shmangies pjesërisht apo tërësisht të pagesës së tatimit që parashihet sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji nr.03/L-222), të sanksionuar sipas nenit 63 par.1, duke dhënë shënime të pavërteta lidhur me të ardhurat e bizneseve të tij “Hotel K“ Sh.p.k., me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore, ka dëmtuar Buxhetin e Republikës së Kosovës me shumën e përgjithshme 22,844.73 euro, në emër të biznesit të lartcekur,

- me këtë kanë kryer veprë penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7,17,41,42,43,46,49,50,51,52,62 par.2nëpar.2.6, 73,74 të KPRK dhe neneve 248, 365,366 të KPP, u shqipton,

DËNIM ME GJOBË dhe ME KUSHT

Të pandehurit E.J.: Dënim me Gjobë në shumë prej **1.000 (njëmijë) euro**, si dhe i përcakton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) V**, i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej **1 (një) V** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i njëjti e përmbush obligimin tatimor në shumë prej 8,268.60 euro ndaj Administratës Tatimore të Kosovës,

Të pandehurit T.B. : Dënim me Gjobë në shumë prej **1.500 euro (njëmijëepesëqind)**, si dhe i përcakton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) V** i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej **1 (një) V** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i njëjti e përmbush obligimin tatimor në shumë prej 22,844.73 euro ndaj Administratës Tatimore të Kosovës,

Nëse të pandehurit nuk e përmbushin obligimin tatimor ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, gjykata dënimin e përcaktuar me kusht në kohëzgjatje prej një V do t'a revokojë për secilin dhe do t'a ekzekutojë duke e shëndrruar në dënim efektiv.

Obligohen dy të pandehurit secili veç e veç të paguajnë dënimin me gjobë në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse nuk e paguajnë dënimin e përcaktuar me gjobë, gjykata secilit do t'ia shndërrojë në dënim me burgim duke llogaritur 20 euro për një ditë.

Obligohen dy të pandehurit secili veç e veç t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **50 (pesëdhjetë) euro** si dhe shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro** në emër të kompensimit të viktimave të krimit në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Të pandehurit E.J gjykata i shqipton edhe **Dënim Plotësues:**

KONFISKOHEN aparatet e lojërave të fatit të precizuara si në urdhëresë të kësaj gjykate për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve PPS nr.109/19 të datës 28.12.2020 (*shih Tabelën e bashkangjitur këtij aktgjykimi si Shtojca 1*)

Për të pandehurin, Edmond (Ramush) J., sendet-automatet që duhet të sekuestrohen,

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (*tutje PSRK*), ka ngritur Aktakuzën PPS.nr.10/2019 të datës 08.01.2021, kundër të pandehurve **E.J** për veprën penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK dhe **T.B** për veprën penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK njëherësh ka propozuar që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor të njëjtit t'i shpall fajtorë, t'i dënojë sipas ligjit dhe, t'i obligojë të kompensojnë Administratën Tatimore të Kosovës (*tutje ATK*) me shumën e tërësishme të dëmit të shkaktuar të precizuar si në aktakuzë.

Duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar kjo gjykatë në Departamentin Special kompetente për të vendosur për aktakuzat e PSRK, ka mbajtur shqyrtim fillestar në të cilin të pandehurit E.J dhe T.B të venë në dijeni të plotë për natyrën, pasojat dhe përparësitë e pranimi të fajësisë, i pandehuri E.J edhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, me vullnet dhe vetëdije të plotë, e pranuan në tërësi fajësinë për veprat penale që iu vihen në barrë. I pandehuri T.B theksoi se tanimë ka arritur një marrëveshje me ATK dhe se është në proces të pagesës së obligimit të tatimit me këste. Mbrojtësi i të pandehurit E.J av.Hekuran Haxhimusa e mbështeti pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij duke shtuar se i njëjti ka pranuar t'a paguajë shumën e detyrimeve ndaj ATK-së sipas raportit të fundit për tatim shtesë.

Sa i përket pranimi të fajësisë së të pandehurit E.J., prokuroria nuk e kundërshton të njëjtin, përkundrazi vlerëson se është e bazuar në prova dhe konform ligjit, kërkon vetëm një kusht lidhur me këtë pranim të fajësisë që borxhi në fjalë të paguhet në tërësi dhe të dorëzohen prova lidhur me pagesën.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga të pandehurit, mbështetjes së dhënë nga mbrojtësi i të pandehurit E.J. dhe pas shprehjes së pajtimit edhe nga prokurori special, në bazë të nenit 248 të KPP, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranim të fajësisë nga neni 248 par.4 të KPP, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit, e bindur se të njëjtit pranimin e fajësisë e kanë bërë në tërësi, secili për veprën penale siç është e precizuar në aktakuzë dhe atë në mënyrë të vullnetshme, pa kurrfarë presioni, duke qenë në dijeni të plotë për natyrën, pasojat dhe përparësitë e pranimi të fajësisë, dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza e cila nuk ka asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike.

Meqenëse për dy të pandehurit gjykata aprovoi pranimin e fajësisë dhe për të njëjtit nuk është e nevojshme të vazhdohet me procedim provash, në seancë të veçantë ka vërtetuar fakte relevante që do të ndikonin në nxjerrjen e vendimit, si faktin e sekuestrimit të sendeve dhe ngrirjes së llogarive të t'pandehurve si dhe faktin nëse i akuzuari T vërtetë ka lidhur marrëveshje për pagesën e obligimit tatimor dhe, këtë fakt fillimisht e ka konfirmuar me ATK në mënyrë zyrtare dhe bazuar në korrespondencën zyrtare të datës 27.05.2021 është e konstatuar se për biznesin "Hotel K" i pandehuri T si person përgjegjës ka lidhur marrëveshje me ATK për pagesën me këste të obligimit tatimor dhe deri më tani i njëjti i është përmbajtur të njëjtës marrëveshje përkatësisht ka paguar shumën prej 13,450.00 euro, e cila marrëveshje do të zgjasë deri më datë 16.09.2022.

Sa i përket këtyre fakteve, Prokurori Special ka theksuar se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duhet t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethana lehtësuese gjykata duhet të vlerësoj faktin se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare duke i llogaritur pasojat dhe benefitet që sjellë pranimi i fajësisë, të njëjtit i janë përgjigjur me kohë ftesave të prokurorisë dhe të kësaj gjykate, ndërsa si rrethana rënduese gjykata duhet t'i merr parasysh rëndësinë e veprës penale që të njëjtit e kanë kryer, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, të kaluarën e tyre kriminale sipas sistemit të evidencës së të dënuarve. Në vazhdim i njëjti, sa i përket urdhëresave që kjo gjykatë ka lëshuar lidhur me sekuestrimin, kërkon nga kjo gjykatë që të njëjtëve t'iu konfiskohen përherë sendet të cilat janë sekuestruar me rastin e urdhërit për bastisje dhe kontroll apo urdhërit për kontroll të lëshuar nga kjo gjykatë për mjetet të cilat kjo prokurori konsideron se në bazë të këtyre aparateve është kryer vepra penale për të cilën ngarkohet, edhe poe qese të njëjtat gjykata ia kthen, i njëjti nuk mund ta ushtrojë këtë veprimtari për shkak se është i ndaluar me ligj si aktivitet për çka edhe ex-officio do të duhej të konfiskohen. Po ashtu, ka kërkuar që lidhur me dëmin që kanë shkaktuar të njëjtit ta paguajnë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.J., av.Hekuran Haxhimusa pajtohet me qëndrimin e prokurorisë speciale se nga mjetet të cilat janë deponuar në fillim për marrjen e licencës për veprimtarinë e lojërave të fatit të paguhet fillimisht vlera e shmangur e obligimit tatimor ndërsa pjesa tjetër t'i kthehet biznesit pasi që i njëjti nuk është akuzuar për atë vepër për të cilën është dyshuar fillimisht, gjithashtu të lirohen llogaritë bankare personale sipas urdhërit ndalues të kësaj gjykate duke kërkuar edhe kthimin e sendeve të sekuestruara siç janë aparatet e lojërave të fatit

për të cilat nuk ka kurrfar dyshimi se janë siguruar në mënyrë jo ligjore edhe nuk ka akuzë lidhur me këtë çështje. Ndërsa sa i përket rrethanave që gjykata duhet t'i ketë parasysht është fakti se firma e të njëjtit ka paguar qindra e mijëra detyrime tatimore në buxhetin e shtetit ditën kur është bërë kontrolli në Vn 2019 në gjendjen e ATK-së nuk e ka pasur asnjë detyrim të pa paguar, mirëpo obligimi tatimor që ceket në akuzë ka rrjedhë pas asaj kohe sipas një raport kontrolli nga ana e ATK-së si tatim shtesë për shkak të detyrimeve të disa shpenzimeve. Në fund i propozon gjykatës që, si rrethanë lehtësuese të merr parasysht që i njëjti asnjëherë nuk ka qenë i dënuar më parë, iu ka përgjigjur ftesave dhe është hera e parë që përballet me këto çështje.

Sa i përket aparateve konsideron se kërkesa e prokurorisë është në kundërshtim me nenin 313 të KPRK meqenëse kjo dispozitë nuk parasheh kurrfar konfiskimi ndërsa fakti se të njëjtat janë të ndaluara më ligj të futen në aktivitet, nuk ka kurrfarë baze juridike që i njëjti të zhvishet nga pronësia e tyre pasi që pronari i mallit-aparatit të njëjtat mund t'i shet në vendet tjera ku është e lejuar ose të pret derisa të vjen një ligj tjetër që mund t'i lejojë lojërat e fatit. Kjo, meqë të njëjtat janë importuar në mënyrë të rregullt, janë paguar detyrimet tatimore, dogana dhe ATK posedojnë evidencë për secilin aparat me numër serik, pasiqë të njëjtit kanë qenë të licencuara për ushtrimin e lojërave të fatit dhe mund të ruhen në një vend sipas kërkesës së pronarit të këtyre aparateve nën mbikqyrjen e doganës dhe ATK ashtu siç kanë qenë gjithmonë.

I pandehuri E.J e ka mbështetur deklarin e mbrojtësit të tij, ndërsa sa i përket obligimit, i njëjti ka pranuar që t'i paguajë detyrimet në vlerën sa është e caktuar në aktakuzë.

I pandehuri T.B ka ritheksuar se tani është duke e paguar obligimin tatimor, ndërsa nuk i është konfiskuar asgjë dhe nuk i është ngrirë asnjë llogari bankare.

Gjykata pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha rrethanave të çështjes penale konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurve E.J dhe T.B ekzistojnë elementet e veprës penale që u vihet në barrë secilit, andaj pasi që më parë gjeti se janë penalisht përgjegjës, të njëjtit i shpalli fajtor, përkatësisht të pandehurin E.J për veprën penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK ndërsa të pandehurin T.B për veprën penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK dhe, secilit i shqiptoi dënim të paraparë ligjor të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Rrjedhimisht gjykata dënimet e shqiptuara me burgim të njëjtëve ua kushtëzoi kompensimin e dëmit ndaj ATK-së për kohë të caktuar që kanë shkaktuar me vepër penale, përkatësisht për shumën që është objekt i akuzës brenda afatit të dhënë nga gjykata. Njëherësh gjykata bashkë me detyrimin për të kompensuar dëmin ndaj ATK, të pandehurve u caktoi edhe revokimin e dënimit dhe ekzekutimin e dënimit të përcaktuar me burgim prej një V

nëse deri në përfundim të kohës së verifikimit nuk e kompensojnë të dëmtuarën ATK me shumën e tërësishme të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë matjes së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73,74 të KPRK që përcaktojnë llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurit, si rrethanë posaçërisht lehtësuese pati parasysh pranimin e plotë të fajësisë, gatishmërinë e tyre për të paguar dëmin e shkaktuar ndaj ATK brenda afatit të dhënë nga gjykata, kurse si rrethanë posaçërisht rënduese për të akuzuarit nuk gjeti, andaj gjykata të njëjtëve u shqiptoi dënime me gjobë si dhe me burgim të kushtëzuar me obligimin për të kompensuar dëmin ndaj ATK, pasi që vlerësoi se dënimi i tillë për secilin është adekuat dhe i drejtë, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të t'pandehurve, se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se të akuzuarit në të ardhmen nuk do të përsërisin veprën tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për të obliguar të pandehurit për kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj ATK, gjykata e mori në bazë të neneve 51 dhe 59 të KPRK.

Vendimin lidhur me dënimin plotësues gjykata e mori në bazë të nenit 62 par.2 nënpar.2.6 të KPRK, ashtu që të pandehurit E J., i konfiskoi aparatet me numra serik sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të precizuara në Urdhërin për Sekuestrim të përkohshëm të sendeve të kësaj gjykate PPPS.nr.109/19 të datës 28.12.2020 pasi nga ushtrim i veprimtarisë nëpërmjet këtyre aparateve i pandehuri iu ka shmangur obligimit tatimor, përkatësisht ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet. Poashtu gjykata ka vlerësuar se aparatet e konfiskuara shërbejnë për të vetmin qëllim që është ushtrimi i veprimtarisë së lojërave të fatit, por duke pasë parasysh se kjo veprimtari është e ndaluar me ligjin 06/L-155 në fuqi nga data 10.05.2019, të njëjtat konsiderohen si asete jashtë qarkullimit juridik përdorimi i të cilave është ligjërisht i ndaluar në territorin e Republikës së Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Vendimin për pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË P., /DEPARTAMENTI SPECIAL

PS.nr.22/2021, me datë 27.05.2021

Lindita Sylejmani
Bashkëpunëtoresh profesionale

Suzana Çerkini
Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në P., .

Shtojca 1

Tabela me Aparate të lojërave të fatit të precizuara si në urdhëresë të kësaj gjykate për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve PPS nr.109/19 të datës 28.12.2020 të të pandehurit E.J

Nr. rend	Nr. serik	Emërtimi
1	Roulet	25/16
2	MERKUR	3111400273
3	KAJOT	207
4	MERKUR	3111400281
5	EGT	10333
6	EGT	10334
7	KAJOT	206
8	MERKUR	3111400258
9	MERKUR	3111400284
10	MERKUR	3111400271
11	MERKUR	6095100144
12	MERKUR	6095100012
13	MERKUR	6095100147
14	MERKUR	6095100114
15	MERKUR	3111400282
16	MERKUR	3111400274
17	MERKUR	3111400283
18	MERKUR	3111400273
19	MERKUR	3111400289
20	MERKUR	3111400286
21	MERKUR	584553
22	MERKUR	584553

23	MERKUR	6055100153
24	EGT	4031
25	EGT	10336
26	EGT	10337
27	EGT	4022
28	EGT Rolet	4023
29	EGT	4288
30	MERKUR	3111400275
31		3111400888
32	MERKUR	6095100152
33	MERKUR	3111400287
34	MERKUR	2016155
35	MERKUR	553348
36	MERKUR	6595302
37	MERKUR	513820
38	Roulet QUBO	23/16
39	MERKUR	2016135
40	MERKUR	2016137
41	MERKUR	2016138
42	MERKUR	584381
43	MERKUR	2661
44		2016012
45	MERKUR	2230
46	MERKUR	1048
47	MERKUR	2782
48	MERKUR	2652
49	MERKUR	2751
50	MERKUR	553382
51	MERKUR	2016150
52	KAJOT	2016103
53	MERKUR	2016103
54	MERKUR	1034
55	MERKUR	1006

56	MERKUR	1012
57	EGT	9509
58	EGT	9510
59	EGT	9505
60	EGT	9513
61	EGT	10330
62	EGT	9512
63	EGT	10328
64	EGT	9508
65	Gold Rolet	7301
66	MERKUR	200002
67	KAJOT	1212
68	KAJOT	210
69	KAJOT	213
70	MERKUR	3111400280
71	MERKUR	6095100114
72	MERKUR	3111400279
73	MERKUR	3111400277
74	MERKUR	3111400276
75	MERKUR	314540688
76	MERKUR	311400261
77	MERKUR	311400272
78	MERKUR	311400278
79	EGT	1735477
80	KAJOT	208
81	NOVOMATIK	200026
82	KAJOT	209
83	AGI	209118
84	rolet	VX3806
85	NOVOMATIK	200013
86	MERKUR	3145400630
87	KAJOT	6085100146
88	MERKUR	3145300660

89	MERKUR	1735466
90	MERKUR	216101
91	Admiral	200038
92	EGT	1735471
93	MERKUR	314540653
94	MERKUR	314540647
95	MERKUR	314540661
96	egt	2016123
97	MEKUR	3143406138
98	MERKUR	6095100116
99	MERKUR	2016117
100	MERKUR	3145400676
101	MERKUR	3145400627
102	MERKUR	3143400679
103	MERKUR	3143400692
104	AGI	200011
105	MERKUR	6147900004
106	MERKUR	3160000042
107	BALLY	XBG00Ö1ã5
108	MERKUR	6107900006
109		XBG000i77
110	MERKUR	6107900021
111	MERKUR	6107900029
112	MERKUR	3160000019
113	MERKUR	6107900022
114	MERKUR	3145400674
115	MERKUR	3111400258
116	MERKUR	6095100110